REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

# EKONOMIA DHE BUXHETI

2014






**SHTATOR**

# *Raporti Mujor*

*Shtator, 2014*

*Kontakt:*

*e-mail: marsed.harizi@financa.gov.al*

*e-mail: ernil.sabaj@financa.gov.al*

(website - www.financa.gov.al)

# PËRMBAJTJA

VEÇORITË KRYESORE....................2

ZHVILLIMET EKONOMIKE....................3

1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit 3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit 4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave 5
4. Bilanci i Pagesave 6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar 7
6. Kredia për Ekonominë 8
7. Oferta e Parasë 9
8. Depozitat sipas Burimeve 10

SEKTORI FISKAL....................11

1. Buxheti i Konsoliduar 11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve 12

ANEKSI STATISTIKOR....................13

# VEÇORITË KRYESORE

- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin shtator 2014 arriti në 116.31 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin shtator ishte 1.5 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit* të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja për muajin shtator 2014 ishte 104.58 lekë për dollarë dhe 139.31lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në lekë* gjatë muajit shtator shënuan kuotat1.59 për ato 12-mujore, 1.35 për 6-mujoret ,1.04 për qind për depozitat 3-mujore dhe 1.80 për depozitat 1-mujore;
- *Normat e interesit për huatë në lekë* ishin 7.56 për qind për huatë 12-mujore dhe 9.38 për ato 6-mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,165,5 miliardë lekë në muajin shtator, duke shënuar një rritje prej rreth 1.0 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për peridhën T2 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej 67.5 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për periudhën janar-shtator 2014 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 30.6 miliardë lekë, ose 3.3 për qind më pak e planit për këtë muaj (e cila ishte 31.6 miliardë).
- *Të ardhurat gjithsej* të realizuara gjatë periudhës janar - shtator 2014, arritën në rreth 266.7 miliardë lekë, ose 100.1 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet gjithsej* gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 297.3 miliardë lekë, ose 99.8 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë muaj.

# ZHVILLIMET EKONOMIKE

## 1.Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin shtator 2014 shënoi një rritje prej 0.3 për qind krahasuar me muajin gusht '14, kur ky indeks shënonte një rritje prej 0.1 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit korrik '14, ky indeks ishte 0.6 për qind më i i ulët se në muajin qershor '14. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë ishin 1.5 për qind, 2.0 për qind dhe 1.8 për qind. Rënia me e madhe mujore, gjatë muajit shtatoru konstatua në grupin "Shëndeti" me 5.7 për qind. Pesha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit (rreth 0.2 pikë përqindjeje). Ndërsa rritja më e madhe u konstatua në grupin "Mallra dhe shërbime të ndryshme" me 8.7 për qind (duke kontribuar me 0.4 pikë përqindje në normën e inflacionit).

Fig-1




***Ndryshimet mujore të IÇK-së***

Burimi: INSTAT

Norma vjetore e inflacionit në muajin shtator arriti në 1.5 për qind, duke qëndruar poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitet 2013 dhe 2014 paraqiten në tabelën 1.

Tab - 1 ***Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)***

| *VITI* | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor |
|---|---|---|---|---|---|---|
| ***2013*** | 2.7 | 2.5 | 2.4 | 2.3 | 2.1 | 2.3 |
| ***2014*** | 1.7 | 1.9 | 2.2 | 1.7 | 1.6 | 1.5 |
| *VITI* | Korrik | Gusht | **Shtator** | Tetor | Nëntor | Dhjetor |
| ***2013*** | 1.6 | 1.2 | 1.7 | 1.7 | 1.0 | 1.9 |
| ***2014*** | 1.8 | 2.0 | **1.5** | | | |

*Burimi: INSTAT*

# 2.Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin shtator 2014, arriti në 139.97 lekë/euro, duke shënuar një rënie me 0.5 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit shtator, një euro u këmbye me 139.89 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin shtator 2014, arriti në 108.41 lekë/dollarë duke shënuar një rritje prej 3.7 për qind kundrejt muajit gusht '14. Në fund të muajit shtator, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 110.89 lekë/dollarë. Në krahasim me muajin shtator të vitit të kaluar,rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 2.9 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro është mbiçmuar me 0.4 për qind. Nënçmimi dhe mbiçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane euro dhe monedhës amerikane, në radhë të parë është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 0.775 euro/dollarë.

Fig-2




***Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit shta'14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

# 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit shtator 2014, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.59 për qind, duke shënuar një rënie me 0.24 pikë përqindje krahasuar me muajin gusht2014. Rënie për këtë muaj ka patur në normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 1, 3 dhe 6-mujore respektivisht me 0.17, 0.09 dhe 0.02 pikë përqindje, duke shkuar përkatësisht në 1.80, 1.04 dhe 1.35 për qind. Rritje për këte muaj nuk ka patur në normat e interesit të asnjë prej depozitave me afat maturimi. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 1, 3, 6 dhe 12-mujore.

Fig-3




***Normat e interesit për depozitat (%)***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit shtator pësoi një rënie me 0.4 pikë përqindje, duke arritur në 7.56 për qind nga 7.96 për qind që ishte në muajin gusht 2014. Për këtë muaj, norma e interesit të huave 6-mujore shënoi një rritje me 0.77 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin shtator arriti në 9.38 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, kanë pësuar rënie normat e interesit të huave me afate maturimi 12 – mujore, ndërsa normat e interesit të huave me afate maturimi 6 – mujore kanë pësuar rritje.

Fig-4




***Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit shtator 2014, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.20, 3.13dhe 3.08 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re një rënie në *yield*-et e bonove të thesarit për afatet e maturimit 6-mujore me 0.01 pikë përqindje, Në ato 3-mujore është vënë re një rritje prej 0.03 pikë përqindje, ndërsa ato 12 – mujore kanë qëndruar të pandryshuara.

# 4.Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për periudhën janar–qershor 2014 regjistroi nje deficit të përgjithshëm prej 67.5 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. Kontributin më të madh në të e jep zëri i "Llogaria korrente" së bashku me nënzërat e saj, me -617.9 milionë euro, duke u rritur në vlerë absolute me 16.7% krahasuar me 6-mujorin e parë të vitit 2013. "Llogaria kapitale dhe financiare" për 6-mujorin e parë vitit 2014 rezultoi të jetë me një deficit prej 345.41 milionë euro, ose gati 166% më e ulët se në 6-mujorin e parë të vitit 2013.

Fig-5




***Bilanci i Pagesave T2 2014***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Kompozicioni i llogarisë korrente prej 617.9 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për periudhën janar –qershor '14: *(i)* bilanci tregtar -932.5 mln euro, *(ii)* shërbime neto 34.0 mln euro, *(iii)* të ardhura neto -35.2 mln euro, (iv) transferta neto 315.9 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.

Fig-6




***Llogaria Korente T2 2014***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit shtator2014, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), në rreth 38,691.0 milionë lekë krahasuar me shtatorine vitit 2013. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 22,922.7 milionë lekë dhe si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë, me rreth 15,768.3 milionë lekë.

Fig-7




***Ecuria e M.V.N. të sistemit në shta'13 - shta'14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në muajin shtator '14 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 8,244.0 milionë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin gusht'14, rritje e cila erdhi si rezultat i rritjes së nivelit të mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 4,694.7 milionë lekë dhe rritjes nga ana tjetër e nivelit të mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 3,549.3 milionë lekë duke e ndihmuar edhe më tepër rritjen e mjeteve valutore neto të sistemit bankar.

Fig-8




***Agregati M3 shta'13 - shta'14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 6. Kredia për Ekonominë

Teprica e kredisë për ekonominë për muajin shtator 2014 arriti në 556.3 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me fundvitin 2013 shënoi gjatë muajit shtator një rritje me vlerë 8.4 miliardë lekë, pra një rritje prej rreth 1.5 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave vazhdon të mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 59.0 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 328.1 miliardë lekë. Gjatë muajit shtator 2014, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 66.9 për qind ose 372.2 miliardë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin e 27.08 për qind ose 150.6 miliardë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 4.4 dhe 1.5 për qind apo 24.7 dhe 8.3 miliardë lekë.

Fig-9




***Rritja e stokut total të kredive***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin shtator ’14, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 56.18 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.34 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 8.76 për qind. “Korporata private jo-financiare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 74.35 për qind dhe rreth 22.72 për qind.

Fig-10




***Përberja e kredive shtator'14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin shtator ka shënuar një rënie krahasuar me muajin paraardhës gusht 2014. Kjo ofertë arriti në rreth 1,165.5 miliardë lekë në fund të muajit shtator '14 duke shënuar një rënie prej 2.6 miliardë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin gusht '14. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 1.0 për qind, duke ruajtur kështu tendencën rritëse të shfaqur që nga mesi i dy viteve më përpara. Ndërsa krahasuar me muajin paraardhës gusht '14, oferta e parasë shënoi një rënie të lehtë prej 0.2 për qind.

Fig-11




***Raporte të parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar një rënie prej 10.9 miliardë lekë në krahasim me muajin shtator 2013. Depozitat në valutë gjatë muajit shtator '14 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 86.1 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 88.6 për qind të tyre.

Fig-12




***Raporti i Depozitave ndaj M3***

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit shtator 2014, zëri "Sektorë të tjerë rezidentë" zuri nivelin më të lartë të depozitave të trasferueshme në lekë, me rreth 88.6 për qind, ndjekur nga "Korporata të tjera jo-financiare", me rreth 8.9 për qind dhe nga "Korporata jo-financiare publike", me 1.7 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" dhe "Korporata të tjera jofinanciare" ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 86.1 për qind dhe rreth 11.8 për qind. "Sektorë të tjerë rezidentë" ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 87.4 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




***Rritja e stokut total të depozitave***

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, "Sektorë të tjerë rezidentë" përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 838.2 miliardë) të depozitave totale, prej rreth 959.4 miliardë lekë në muajin shtator 2014. Ata ndiqen nga "Korporata të tjera jo-financiare" (100.0 miliardë), "Korporata jo-financiare publike" (13.9 miliardë) dhe "korporata të tjera financiare" (7.0 miliardë). "Qeveria lokale" kontribuoji me rreth 1.4 miliardë në totalin e depozitave. Gjatë muajit shtator 2014, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave pësoi një rënie prej 2.9 miliardë lekë, kjo si rezultat i rënies së depozitave në valutë me rreth 1.8 milliardë lekë dhe rënies së depozitave në lekë me rreth 1.1 miliardë lekë.

Fig-14




***Përberja e depozitave shta '14***

Burimi: Banka e Shqipërisë

# SEKTORI FISKAL

## 1.Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar - shtator 2014 janë mbledhur rreth 266.7 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 297.3 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 241.5 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 29.9 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 38.7% janë financim i brendshëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 100.1% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 99.8% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 100.5% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 101% të tij.

Fig - 15




*Treguesit Fiskal, janar - shtator 2014*

Burimi: Ministria e Financave

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 186.6 miliardë lekë (ose rreth 99.8% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 9.7miliardë lekë (ose rreth 100.4% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore46.9 miliardë lekë (ose 100% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 16 miliardë lekë (ose rreth 105.1% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 241.5 miliardë lekë, 52.8 miliardë lekë (21.9% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 28.7 miliardë lekë (11.9%) për interesat, 20.8 miliardë lekë (8.6%) për shpenzime operative dhe mirëmbajtje, 944 milionë lekë (0.4%) për subvencione, 101 miliardë lekë (41.8%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 19.9 miliardë lekë (8.2%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 17.2 miliardë lekë (7.1%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 71.7% (shpenzime personeli), 67.3% (shpenzime për interesat), 57% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 59% (subvencione),74.7% (sigurimetshoqërore dhe shëndetësore), 53.5% dhe 69.2% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 31.3%, ndërsa financimi i huaj është 63.1% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të Ardhurat sipas Burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar - shtator 2014 ishin rreth 266.7 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 243.3 miliardë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 16 miliardë lekë.

Tab - 2 *Të ardhurat gjatë janar - shtator 2014 (në mld Lekë)*

| Burimi | sht '14 | sht'13 | Ndryshimi në (%) |
|---|---|---|---|
| TVSH | 91.9 | 79.1 | 16.2 |
| Tatimi mbi fitimin | 16.1 | 11.6 | 38.8 |
| Taksa doganore | 4.2 | 4.1 | 2.4 |
| Taksat nacionale | 24.6 | 20.3 | 21.2 |
| Akcizat | 29.3 | 25.4 | 15.4 |
| Tatim mbi të ardhuart personale (TAP) | 20.5 | 21.7 | -5.5 |

**Burimi:** *Ministria e Financave: Statistika Fiskale Mujore: janar - shtator 2014.*

## 3.Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 30.6 miliardë lekë, për periudhën janar - shtator 2014, u mbështet në vlerën 1.4 miliardë lekë nga burime të brendshme dhe rreth 29.2 miliardë nga burime të jashtme. Huamarrja e brendshme ishte mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 108.6% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishin huatë afatgjata (rreth 39.5% të totalit të deficit).

Për muajin shtator 2014, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 30.332 miliardë lekë,
- Realizimi i shpenzimeve në masën 29.938miliardë lekë,

Në realizimin e të ardhurave për muajin shtator 2014, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 28.5 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 26.9 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 3 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1

| | Mujor (Monthly ) | | | | | | Mesatar Mujor (Monthly Average) | | | | | | Vjetor (Annual) | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Muaji | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | **2014** | Month |
| Janar | 0.4 | 0.9 | 0.8 | 0.7 | 1.0 | 0.8 | 0.40 | 1.00 | 0.80 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 2.1 | 3.6 | 3.3 | 1.6 | 2.7 | 1.7 | January |
| Shkurt | 0.7 | 1.1 | 2.3 | 1.3 | 1.1 | 1.4 | 0.55 | 1.02 | 1.55 | 1.01 | 1.05 | 1.10 | 1.9 | 4.7 | 4.5 | 0.6 | 2.5 | 1.9 | February |
| Mars | 0.6 | 0.1 | -0.1 | 0.4 | 0.2 | 0.5 | 0.57 | 0.71 | 1.00 | 0.80 | 0.77 | 0.90 | 1.6 | 4.1 | 4.3 | 1.0 | 2.4 | 2.2 | March |
| Prill | -0.1 | -0.4 | -0.6 | -0.1 | -0.1 | -0.6 | 0.40 | 0.42 | 0.60 | 0.58 | 0.55 | 0.53 | 1.9 | 3.7 | 4.1 | 1.6 | 2.3 | 1.7 | April |
| Maj | -0.8 | -1.2 | -1.1 | -0.8 | -1.0 | -1.1 | 0.16 | 0.10 | 0.26 | 0.32 | 0.24 | 0.20 | 2.1 | 3.3 | 4.2 | 1.9 | 2.1 | 1.6 | May |
| Qershor | -0.6 | -0.7 | -1.1 | -0.8 | -0.6 | -0.7 | 0.03 | -0.04 | 0.04 | 0.12 | 0.15 | 0.05 | 2.3 | 3.2 | 3.9 | 2.2 | 2.3 | 1.5 | June |
| Korrik | -0.7 | -0.5 | -0.7 | -0.2 | -0.8 | -0.6 | -0.07 | -0.10 | -0.07 | 0.08 | -0.03 | -0.04 | 2.2 | 3.4 | 3.6 | 2.7 | 1.6 | 1.8 | July |
| Gusht | 0.7 | 0.8 | 0.3 | 0.4 | -0.1 | 0.1 | 0.03 | 0.01 | -0.02 | 0.12 | -0.04 | -0.03 | 2.2 | 3.5 | 3.1 | 2.8 | 1.2 | 2.0 | August |
| **Shtator** | 0.8 | 0.7 | 0.4 | 0.2 | 0.8 | **0.3** | 0.11 | 0.09 | 0.02 | 0.13 | 0.06 | **0.01** | 2.0 | 3.4 | 2.8 | 2.6 | 1.7 | **1.5** | **September** |
| Tetor | 0.4 | 0.2 | 0.4 | 0.2 | 0.1 | | 0.14 | 0.10 | 0.06 | 0.14 | 0.05 | | 2.3 | 3.0 | 3.0 | 2.4 | 1.7 | | October |
| Nëntor | 0.4 | 0.2 | 0.1 | 0.2 | -0.5 | | 0.16 | 0.11 | 0.06 | 0.14 | 0.01 | | 2.8 | 2.8 | 2.9 | 2.5 | 1.0 | | November |
| Dhjetor | 1.6 | 2.2 | 1.0 | 0.9 | 1.7 | | 0.28 | 0.28 | 0.14 | 0.20 | 0.15 | | 3.7 | 3.4 | 1.7 | 2.4 | 1.9 | | December |

*Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë* *Source : INSTAT,Bank of Albania*

Tab - 2 **Kursi i këmbimit**

Exchange rate

Lekë për njësi të monedhës së huaj *(Lek per unit of foreign currency)*

| Monedha | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | Aug | Sep | Currency |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Mesatarja e periudhës* | | | | | | | | | | | | | | | *Average of period* |
| USD | 94.98 | 103.94 | 100.90 | 108.18 | 105.67 | 103.24 | 102.75 | 101.55 | 101.35 | 101.89 | 103.09 | 103.26 | 104.58 | 108.41 | USD |
| EURO | 132.06 | 137.79 | 140.33 | 139.04 | 140.27 | 140.54 | 140.32 | 140.29 | 140.01 | 139.99 | 140.13 | 139.91 | 139.31 | 139.97 | EURO |
| *Fundi i periudhës* | | | | | | | | | | | | | | | *In the end of period* |
| USD | 95.81 | 104.00 | 107.54 | 105.85 | 101.86 | 103.66 | 101.58 | 101.89 | 101.36 | 102.72 | 102.78 | 103.81 | 105.84 | 110.89 | USD |
| EURO | 137.96 | 138.77 | 138.93 | 139.59 | 140.20 | 140.44 | 140.14 | 140.27 | 140.08 | 139.86 | 140.26 | 139.02 | 139.44 | 139.89 | EURO |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 3 **Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)**

Annual Interest Rates (in ALL)

| Në përqindje | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | Aug | Sep | In percent |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Norma e depozitave** | | | | | | | | | | | | | | | **Deposits rates** |
| 12-M | 6.78 | 6.07 | 5.87 | 5.38 | 4.17 | 2.39 | 2.46 | 2.16 | 2.21 | 1.94 | 1.76 | 1.90 | 1.83 | 1.59 | 12-M |
| 6-M | 5.74 | 5.16 | 4.87 | 4.50 | 3.40 | 1.87 | 1.87 | 1.66 | 1.80 | 1.62 | 1.33 | 1.36 | 1.37 | 1.35 | 6-M |
| 3-M | 5.05 | 4.42 | 4.22 | 3.83 | 2.72 | 1.31 | 1.53 | 1.12 | 1.22 | 1.07 | 0.97 | 1.06 | 1.13 | 1.04 | 3-M |
| 1-M | 4.56 | 4.70 | 4.39 | 3.62 | 2.79 | 2.43 | 2.51 | 2.25 | 2.21 | 2.12 | 2.06 | 2.03 | 1.97 | 1.80 | 1-M |
| **Norma e huasë** | | | | | | | | | | | | | | | **Lending rates** |
| 12-M | 12.46 | 11.52 | 11.17 | 10.28 | 9.52 | 8.67 | 8.49 | 6.47 | 8.60 | 9.50 | 8.20 | 8.39 | 7.96 | 7.56 | 12-M |
| 6-M | 12.54 | 11.69 | 12.28 | 10.61 | 9.59 | 9.36 | 8.77 | 9.34 | 8.00 | 8.61 | 9.40 | 8.31 | 8.61 | 9.38 | 6-M |
| **Norma e letrave me vlerë** | | | | | | | | | | | | | | | **Securities rates** |
| Bono thesari 1/ | | | | | | | | | | | | | | | Treasury bills 1/ |
| 3-M | 6.30 | 5.29 | 5.31 | 5.03 | 3.40 | 3.36 | 3.24 | 3.14 | - | 3.05 | 3.02 | 2.95 | 3.05 | 3.08 | 3-M |
| 6-M | 7.52 | 6.41 | 6.23 | 5.65 | 3.54 | 3.71 | 3.52 | 3.40 | 3.32 | 3.27 | 3.14 | 3.16 | 3.14 | 3.13 | 6-M |
| 12-M | 9.14 | 7.09 | 6.95 | 6.37 | 3.66 | 3.82 | 3.79 | 3.66 | 3.56 | 3.40 | 3.26 | 3.23 | 3.20 | 3.20 | 12-M |

*Burimi : Banka e Shqipërisë* *Source : Bank of Albania*

Tab - 4

**TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2014**

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2014

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* — *në milionë Lekë (in million Lek)*

| Nr. | E M Ë R T I M I | Janar January | Shkurt February | Mars March | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht August | Shtator September | ITEMS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **TOTALI TË ARDHURAVE** | **27,774** | **53,273** | **82,107** | **116,161** | **144,587** | **175,206** | **206,183** | **236,397** | **266,729** | **TOTAL REVENUE** |
| I. | **Të ardhura nga ndihmat** | **624** | **1,658** | **2,991** | **3,507** | **4,053** | **5,345** | **6,369** | **6,909** | **7,467** | **Grands** |
| II. | **Të ardhura tatimore** | **24,326** | **47,226** | **73,627** | **103,682** | **129,906** | **157,502** | **185,910** | **214,732** | **243,272** | **Tax Revenue** |
| II.1 | **Nga Tatimet dhe Doganat** | **17,534** | **35,349** | **56,298** | **77,924** | **98,335** | **120,335** | **141,282** | **164,097** | **186,626** | **From tax offices and customs** |
| 1 | Tatimi mbi Vlerën e Shtuar | 9,472 | 19,155 | 28,677 | 40,626 | 50,331 | 61,177 | 70,693 | 81,599 | 91,908 | V.A. T |
| 2 | Tatimi mbi Fitimin | 1,007 | 2,363 | 6,332 | 7,950 | 9,477 | 11,167 | 12,587 | 13,924 | 16,109 | Profit Tax |
| 3 | Akcizat | 1,616 | 3,660 | 6,110 | 9,083 | 12,500 | 16,274 | 19,923 | 24,850 | 29,297 | Excise Tax |
| 4 | Tatimi mbi të Ardhurat Personale | 2,569 | 4,576 | 6,444 | 8,716 | 10,903 | 13,160 | 16,242 | 18,261 | 20,476 | Personal Income Tax |
| 5 | Taksa Nacionale dhe të tjera | 2,482 | 4,806 | 7,494 | 9,842 | 12,869 | 15,802 | 18,582 | 21,722 | 24,587 | National Taxes and others |
| 6 | Taksa Doganore | 388 | 789 | 1,241 | 1,707 | 2,255 | 2,755 | 3,255 | 3,741 | 4,249 | Customs Duties |
| II.2 | **Të ardhura nga Pushteti Vendor** | **796** | **1,340** | **2,162** | **4,462** | **5,448** | **6,235** | **7,571** | **8,600** | **9,693** | **Revenues from Local Gov.** |
| 1 | Taksë mbi Pasurinë (ndërtesat) | 154 | 340 | 663 | 1,691 | 1,931 | 2,211 | 2,412 | 2,653 | 2,890 | Property Tax |
| 2 | Taksë mbi Biznesin e vogël | 304 | 329 | 350 | 379 | 612 | 685 | 1,318 | 1,449 | 1,540 | Small Business Tax |
| 3 | Taksa Lokale | 338 | 671 | 1,149 | 2,392 | 2,905 | 3,339 | 3,841 | 4,498 | 5,263 | Local Taxes |
| II.3 | **Të ardh nga fondet speciale** | **5,996** | **10,537** | **15,167** | **21,296** | **26,123** | **30,932** | **37,057** | **42,035** | **46,953** | **Social ins. contributions** |
| 1 | Sigurimi Shoqeror | 5,257 | 9,209 | 12,860 | 18,429 | 22,562 | 26,776 | 32,160 | 36,562 | 40,853 | Social Insurance |
| 2 | Sigurimi Shëndetsor | 735 | 1,319 | 2,283 | 2,831 | 3,522 | 4,105 | 4,841 | 5,410 | 5,990 | Health insurance |
| 3 | Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve | 4 | 9 | 24 | 36 | 39 | 51 | 56 | 63 | 110 | Revenues for property compesation |
| III. | **Të ardhura Jotatimore** | **2,824** | **4,389** | **5,489** | **8,972** | **10,628** | **12,359** | **13,904** | **14,756** | **15,990** | **Nontax Revenue** |
| 1 | Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë | 165 | 320 | 430 | 1,871 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | 1,951 | Profit transfer from BOA |
| 2 | Të ardhura nga Inst.Buxhetore | 1,810 | 2,630 | 3,254 | 4,818 | 5,654 | 6,575 | 7,116 | 7,504 | 8,168 | Income of budgetary institutions |
| 3 | Dividenti | 498 | 498 | 498 | 498 | 504 | 765 | 1,362 | 1,380 | 1,381 | Divident |
| *4* | Tarifat shërbimeve | 139 | *404* | 612 | *842* | 1,363 | *1,602* | 1,805 | *2,070* | 2,396 | Tariffs on servises |
| 5 | Të tjera | 212 | 537 | 695 | 943 | 1,156 | 1,466 | 1,670 | 1,851 | 2,094 | Other/not allocated |
| | **TOTALI I SHPENZIMEVE** | **24,963** | **54,269** | **88,415** | **122,526** | **156,331** | **197,401** | **236,039** | **267,355** | **297,293** | **TOTAL EXPENDITURE** |
| I. | **Shpenzime Korrente** | **24,285** | **51,451** | **77,884** | **103,308** | **131,222** | **158,492** | **186,355** | **214,576** | **238,906** | **Current Expenditures** |
| I.1 | **Personeli** | **5,645** | **11,394** | **17,268** | **23,174** | **29,083** | **34,938** | **40,905** | **46,928** | **51,040** | **Personnel expenditures** |
| 1 | Paga | 4,856 | 9,811 | 14,864 | 19,954 | 25,031 | 30,068 | 35,215 | 40,410 | 43,722 | Wages |
| 2 | Kontributi për Sigurime Shoqerore | 789 | 1,583 | 2,404 | 3,220 | 4,052 | 4,870 | 5,690 | 6,518 | 7,318 | Social insurance contributions |
| I.2 | **Interesat** | **3,819** | **7,843** | **10,675** | **13,039** | **17,255** | **20,627** | **23,399** | **26,546** | **28,748** | **Interest** |
| 1 | Të Brendshme | 3,476 | 7,058 | 9,502 | 11,290 | 15,144 | 18,075 | 20,521 | 23,225 | 25,059 | Domestic |
| 2 | Të Huaja | 343 | 785 | 1,173 | 1,749 | 2,111 | 2,552 | 2,878 | 3,321 | 3,689 | Foreign |
| I.3 | **Shpenzime Operative Mirëmbajtje** | **1,275** | **3,225** | **6,425** | **8,256** | **9,670** | **11,418** | **14,588** | **17,861** | **20,566** | **Operational & Maintenance** |
| I.4 | **Subvecionet** | **58** | **112** | **265** | **310** | **422** | **579** | **700** | **824** | **874** | **Subsidies** |
| I.6 | **Shpenzime për fonde speciale** | **9,440** | **20,875** | **31,372** | **42,422** | **54,379** | **66,726** | **77,929** | **89,743** | **100,915** | **Social insurance outlays** |
| 1 | Sigurime Shoqerore | 7,432 | 15,127 | 23,165 | 31,405 | 39,633 | 48,179 | 56,742 | 65,923 | 74,813 | Social insurance |
| 2 | Sigurime Shëndetsore | 2,008 | 4,754 | 7,213 | 10,023 | 13,752 | 17,253 | 19,893 | 22,526 | 24,808 | Health insurance |
| 3 | Fondi I kompensimit te pronareve | | | 994 | 994 | 994 | 1,294 | 1,294 | 1,294 | 1,294 | Expenditures for Owners Compensation |
| I.7 | **Shpenzime per Buxhetin Vendor** | **1,214** | **3,120** | **5,041** | **7,535** | **9,927** | **12,121** | **14,837** | **17,123** | **19,626** | **Local budget expenditure** |
| I.8 | **Shpenzime të tjera** | **2,834** | **4,882** | **6,838** | **8,572** | **10,486** | **12,083** | **13,997** | **15,551** | **17,137** | **Other expenditures** |
| 1 | Pagesa e Papunesisë | **112** | 198 | 294 | 387 | 454 | 522 | 591 | 652 | 712 | Unemployment insurance benefits |
| 2 | Ndihma Ekonomike | 2,721 | 4,684 | 6,544 | 8,170 | 9,970 | 11,427 | 13,167 | 14,632 | 16,134 | Social assistance |
| 5 | Kompensimi i ish-të përndjekurve politike | | | 0 | 15 | 62 | 134 | 239 | 267 | 291 | Compansation for ex-political prisioners |
| III | **Shpenzime Kapitale** | **678** | **2,818** | **10,531** | **11,466** | **13,734** | **19,817** | **23,935** | **26,906** | **29,886** | **Capital expenditures** |
| 1 | Financimi Brendshëm | 0 | 641 | 1,309 | 4,025 | 4,615 | 7,109 | 8,893 | 10,225 | 11,559 | Domestically financing |
| 2 | Financimi Huaj | 678 | 2,177 | 9,222 | 7,441 | 9,119 | 12,708 | 15,042 | 16,681 | 18,327 | Foreign financed |
| IV. | **Detyrime te prapambetura** | | | **1,032** | **7,752** | **11,375** | **19,092** | **25,749** | **25,873** | **25,910** | **Arrears** |
| 1 | Detyrimet e infrastruktures | | | | 1,616 | 3,489 | 5,963 | 8,440 | 8,440 | 8,442 | Infrastructure arrears |
| 2 | Detyrimet tatimore | | | 1,032 | 6,136 | 6,758 | 9,010 | 12,575 | 12,699 | 12,730 | Tax arrears |
| 3 | Te tjera | | | | | **1,128** | **4,119** | **4,734** | **4,734** | **4,738** | Others |
| V | **DEFICITI** | **2,811** | **-996** | **-6,308** | **-6,365** | **-11,744** | **-22,195** | **-29,856** | **-30,958** | **-30,564** | **CASH BALANCE** |
| I | **FINANCIMI DEFICITIT** | **-2,811** | **996** | **6,308** | **6,365** | **11,744** | **22,195** | **29,856** | **30,958** | **30,564** | **CASH BALANCE FINANCING** |
| II | **Brendshëm** | **-2,179** | **1,745** | **1,959** | **5,673** | **10,493** | **16,474** | **23,306** | **1,847** | **1,353** | **Domestic** |
| 1 | Të ardhura nga privatizimi | 0 | 1 | 1 | 2 | 4 | 10 | 11 | 19 | 26 | Privatization receipts |
| 2 | Hua-marrje e brendshme | 3,473 | 4,696 | 8,647 | 11,026 | 15,576 | 21,436 | 26,539 | 31,351 | 33,205 | Domestic new borrowing (net) |
| 2.1 | Nacionale | 3,482 | 4,707 | 8,660 | 11,048 | 15,600 | 21,419 | 26,336 | 31,126 | 32,953 | Other |
| 2.2 | Lokale | -9 | -11 | -13 | -22 | -24 | 17 | 203 | 225 | 252 | Foreign |
| 3 | Të tjera | -5,652 | -2,952 | -8,208 | -4,474 | -5,818 | -4,972 | -3,244 | -29,523 | -31,878 | Other |
| 4 | Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë | 1,838 | 4,269 | 771 | 2,125 | 3,815 | 3,145 | 2,435 | -22,414 | -25,896 | Government deposits into the Central Bank |
| 5 | Të tjera | -7,489 | -7,219 | -8,978 | -6,598 | -9,631 | -8,116 | -5,680 | -7,111 | -5,982 | Other |
| 6 | Depozita e ISSH dhe ISKSH | -3,545 | -3,102 | -3,585 | -3,093 | -4,137 | -4,309 | -4,426 | -3,708 | -3,338 | Deposits of Socila and Health insurance |
| 7 | Mjete në ruajtje | 6 | 57 | 23 | 120 | 124 | 318 | 524 | 615 | 618 | Preservation stock |
| 8 | Nënhua | 314 | 369 | 552 | 916 | 1,029 | 1,049 | 1,105 | 1,109 | 1,355 | On-Loan Principal |
| 9 | Detyrim ndaj ISSH | -220 | -99 | -303 | 712 | 78 | -5 | 70 | -15 | 31 | Liabilities to SSI |
| 10 | Të tjera (detyrime të përkohshme) | 563 | 433 | 442 | -781 | -54 | -2 | -21 | 76 | 31 | Other-Float |
| III | **I huaj** | **-632** | **-749** | **1,366** | **617** | **1,304** | **5,721** | **6,550** | **29,111** | **29,211** | **Foreign** |
| 1 | Hua afatgjatë(e marrë) | 198 | 534 | 3,153 | 3,996 | 9,562 | 8,390 | 9,986 | 10,952 | 12,070 | Long-term foreign borrowing (gross) |
| 2 | Nga e cila nënhua | 0 | | 1,665 | 1,642 | 1,670 | 2,109 | 2,145 | 2,157 | 2,164 | |
| 3 | Ndryshimi i gjendjes së arkes* | -142 | -44 | 51 | 185 | 240 | -808 | -747 | -611 | -637 | Chang. of stat. Account |
| 4 | Ripagesat | -688 | -1,385 | -1,984 | -7,399 | -8,498 | -10,125 | -10,953 | -11,690 | -12,682 | Repayments |
| 5 | Mbështetje Buxhetore | 0 | 146 | 146 | 3835 | 4526 | 8264 | 8264 | 30460 | 30460 | Budgetary Support |

*Burimi : Ministria e Financave* — *Source : Ministry of Finance*

**Tab - 5** **Tabela e investimeve 2014**

Table of investments 2014

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million Lek)*

| | Janar<br>January | Shkurt<br>Feb | Mars<br>Mar | Prill<br>Apr | Maj<br>May | Qershor<br>Jun | Korrik<br>Jul | Gusht<br>Aug | **Shtator**<br>**Sep** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Financim i brendshëm** | **0** | **641** | **1,309** | **4,025** | **4,615** | **7,109** | **8,893** | **10,225** | **11,559** | **Domestic financing** |
| *Në %* | *0.00* | *22.75* | *12.43* | *35.10* | *33.60* | *35.87* | *37.15* | *38.00* | *38.68* | *In %* |
| **Financim i huaj** | **678** | **2,177** | **9,222** | **7,441** | **9,119** | **12,708** | **15,042** | **16,681** | **18,327** | **Foreign financing** |
| *Në %* | *100.00* | *77.25* | *87.57* | *64.90* | *66.40* | *64.13* | *62.85* | *62.00* | *61.32* | *In %* |
| **Totali** | **678** | **2,818** | **10,531** | **11,466** | **13,734** | **19,817** | **23,935** | **26,906** | **29,886** | **Total** |
| *Në %* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *100* | *In %* |

Burimi: Ministria e Financave Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2014 (CUSTOMS REVENUES 2014)

*Të dhëna progresive (Progresive Data)* *në milionë Lekë ( in million Lek)*

| | Janar January | Shkurt Feb | Mars Mar | Prill April | Maj May | Qershor June | Korrik July | Gusht Agust | **Shtator September** | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Taksë doganore | 388 | 789 | 1,241 | 1,707 | 2,255 | 2,755 | 3,255 | 3,741 | 4,249 | Customs Duties |
| TVSH | 6,594 | 13,683 | 20,478 | 29,944 | 37,927 | 46,543 | 54,528 | 63,228 | 71,477 | V.A.T |
| Akcizë | 1,616 | 3,660 | 6,109 | 9,083 | 12,499 | 16,273 | 19,922 | 24,849 | 29,295 | Excises |
| Të tjera | 612 | 1,153 | 1,765 | 2,582 | 3,192 | 4,041 | 4,473 | 5,124 | 5,377 | Others |
| **TOTALI** | **9,210** | **19,285** | **29,593** | **43,316** | **55,873** | **69,612** | **82,178** | **96,942** | **110,398** | **Total** |

TË ARDHURAT TATIMORE 2013 (TAX REVENUE )
